

**Udhëzimi nr. 30, datë 12.09.2018, “Për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet e arsimit parauniversitar”**

<b>Baza ligjore</b>	<b>Përshkruesit praktikë</b>	<b>Po/Jo</b>	<b>Komente</b>
Kreu I, Gërma A, Pika 1	Kopshti me ushqim në zonën urbane ka formuar grupet e veçanta të nxënësve, me jo më pak se 25 nxënës që frekuentojnë.		
Kreu I, Gërma A, Pika 2	Kopshti në zonën rurale ka formuar grupe të veçanta të nxënësve, me jo më pak se 15 nxënës që frekuentojnë.		
Kreu I, Gërma A, Pika 3	Kopshti në zonën rurale ka formuar grupet e përziera të nxënësve, me jo më pak se 10 nxënës që frekuentojnë. Në rastet kur ky numër nxënësish nuk është siguruar, kopshti, me miratimin e njësisë së vetëqeverisjes vendore, ka formuar grupet e përziera të nxënësve, me jo më pak se 5 nxënës që frekuentojnë.		
Kreu I, Gërma A, Pika 4	Kopshtet ose shkollat e arsimit bazë kanë formuar klasat përgatitore, të cilat frekuentohen nga nxënës 5 vjeç, që nuk kanë ndjekur arsimin parashkollor. Klasa përgatitore në zonat urbane është formuar me jo më pak se 25 nxënës dhe në zonat rurale me jo më pak se 10 nxënës.		
Kreu I, Gërma B, Pika 1	Kopshti me ushqim ose pa ushqim që ka të paktën 4 grupe të veçanta ose të përziera ka një drejtues.		
Kreu I, Gërma B, Pika 2	Njësia e qeverisjes vendore, në kopshtet që veprimtarinë e tyre e zhvillojnë pranë shkollave 9-vjecare, ka emëruar një drejtues kopshti për jo më pak se 5 grupe nxënësish.		
Kreu I, Gërma C, Pika 1	Drejtori i kopshtit e ka normën mësimore javore 18 orë.		
Kreu I, Gërma C, Pika 2	Drejtori i kopshtit, i përcaktuar në pikën B/2 të këtij kreu, e ka normën mësimore javore 15 orë.		
Kreu I, Gërma C, Pika 3	Mësuesit e kopshtit e kanë normën mësimore javore 30 orë.		
Kreu I, Gërma D	Drejtori i kopshtit ka realizuar normën e vlerësimit të arritjeve me 6 orë në javë.		
Kreu II, Gërma A, Pika 1	Shkolla e arsimit bazë në zonat urbane ka formuar klasat e veçanta, me jo më pak se 15 nxënës. Shkolla e arsimit bazë në zonat rurale ka formuar klasat e veçanta, me jo më pak se 10 nxënës.		
Kreu II, Gërma A, Pika 2, Gërma a	Shkolla e arsimit bazë ka formuar dy klasa paralele, kur numri i nxënësve është 32-65.		
Kreu II, Gërma A, Pika 2, Gërma b	Shkolla e arsimit bazë ka formuar tri klasa paralele, kur numri i nxënësve është 66-99.		
Kreu II, Gërma A, Pika 2, Gërma c	Shkolla e arsimit bazë ka formuar katër klasa paralele, kur numri i nxënësve është 100-133.		
Kreu II, Gërma A, Pika 2, Gërma d	Shkolla e arsimit bazë ka formuar pesë klasa paralele, kur numri i nxënësve është 134-167.		
Kreu II, Gërma A,	Ndarja e klasave (në shkollën e arsimit bazë) në më shumë se		

Pika 3	pesë klasa paralele ka vazhduar sipas rregullit të përcaktuar në pikën 2.		
Kreu II, Gërma A, Pika 4	Numri i punonjësve mësimorë në arsimin fillor është llogaritur një mësues për çdo klasë.		
Kreu II, Gërma B	Në shkollën e arsimit bazë, kur nuk është plotësuar numri i nxënësve për klasë në përputhje me pikën A/1, të kreut II, të këtij udhëzimi, mësimi është organizuar me klasa të bashkuara.		
Kreu II, Gërma B, Pika 1, Gërma a	Në arsimin fillor është formuar një klasë e bashkuar, kur numri i nxënësve në klasat I-V është deri në 10.		
Kreu II, Gërma B, Pika 1, Gërma b	Në arsimin fillor janë formuar dy klasa të bashkuara, kur numri i nxënësve në klasat I-V është në 11-25.		
Kreu II, Gërma B, Pika 1, Gërma c	Në arsimin fillor janë formuar tri klasa të bashkuara, kur numri i nxënësve në klasat I-V është në 26-50.		
Kreu II, Gërma B, Pika 1, Gërma d	Në arsimin fillor janë formuar klasa të veçanta, kur numri i nxënësve i të gjitha klasave I-V është mbi 50, pavarësisht nga numri i nxënësve për klasë.		
Kreu II, Gërma B, Pika 2, Gërma a	Në arsimin e mesëm të ulët është formuar një klasë e bashkuar, kur numri i nxënësve në klasat VI-IX është deri në 10.		
Kreu II, Gërma B, Pika 2, Gërma b	Në arsimin e mesëm të ulët janë formuar dy klasa të bashkuara, kur numri i nxënësve në klasat VI-IX është 11-25.		
Kreu II, Gërma B, Pika 2, Gërma c	Në arsimin e mesëm të ulët janë formuar tri klasa të bashkuara, kur numri i nxënësve në klasat VI-IX është 26-40.		
Kreu II, Gërma B, Pika 2, Gërma d	Në arsimin e mesëm të ulët janë formuar klasa të veçanta, kur numri i nxënësve i të gjitha klasave VI-IX është mbi 40, pavarësisht nga numri i nxënësve për klasë.		
Kreu II, Gërma C, Pika 1	Në shkollën e arsimit bazë, kur numri i nxënësve është më shumë se 80, është emëruar një drejtor shkolle.		
Kreu II, Gërma C, Pika 2	Në shkollën e arsimit bazë, kur numri i nxënësve është 251-500, është emëruar një nëndrejtor.		
Kreu II, Gërma C, Pika 3	Në shkollën e arsimit bazë, kur numri i nxënësve është 501-900, janë emëruar dy nëndrejtorë shkolle.		
Kreu II, Gërma C, Pika 4	Në shkollën e arsimit bazë, kur numri i nxënësve është mbi 900, janë emëruar tre nëndrejtorë shkolle.		
Kreu II, Gërma C, Pika 5	Në shkollën e arsimit bazë, që ka mbi 200 nxënës dhe drejtoria ka në vartësi 4 shkolla, është emëruar një nëndrejtor.		
Kreu II, Gërma C	Kur numri i nxënësve është më pak se 80, është caktuar një kryemësues për të paktën 4 mësues. Numri i nxënësve në kopshte që zhvillojnë veprimtarinë e tyre pranë shkollave dhe nuk administrohen nga drejtues kopshti sipas pikës B, të kreut I të këtij udhëzimi, është llogaritur në numrin e përgjithshëm të nxënësve të shkollës.		
Kreu II, Gërma D, Pika 1	Edukatori në institutet e fëmijëve me aftësi të kufizuar ka normën mësimore javore 30 orë.		
Kreu II, Gërma D, Pika 2	Mësuesi dhe kryemësuesi në arsimin fillor e kanë normën javore, aq sa orë mësimore janë në planin mësimor të klasës ku		

	japin mësim, duke përfshirë dhe orët e punës si mësues kujdestar.		
Kreu II, Gërma D, Pika 3	Në AMU, mësuesi i gjuhës shqipe, i gjuhës së huaj, i matematikës, i fizikës, i biologjisë, i kimisë, informatikës, i historisë, i gjeografisë, mësuesi në shkollat e arsimit special, e kanë normën mësimore 20 orë në javë.		
Kreu II, Gërma D, Pika 4	Mësuesit e lëndëve të tjera në AMU e kanë normën mësimore 22 orë në javë.		
Kreu II, Gërma D, Pika 5	Kryemësuesi në AMU e ka normën mësimore 20 orë në javë (përgjigjet për disiplinën dhe inventarin e shkollës).		
Kreu II, Gërma D, Pika 6	Drejtori i shkollës së arsimit bazë, me 81-300 nxënës, e ka normën mësimore 8 orë në javë.		
Kreu II, Gërma D, Pika 7	Drejtori i shkollës së arsimit bazë, me 301-600 nxënës, e ka normën mësimore 6 orë në javë.		
Kreu II, Gërma D, Pika 8	Drejtori i shkollës së arsimit bazë, me 601-900 nxënës, e ka normën mësimore 4 orë në javë.		
Kreu II, Gërma D, Pika 9	Drejtori i shkollës së arsimit bazë, me mbi 900 nxënës nuk jep mësim.		
Kreu II, Gërma D, Pika 10	Nëndrejtori i shkollës së arsimit bazë, e ka normën mësimore 8 orë në javë.		
Kreu II, Gërma D	Drejtori dhe nëndrejtorët e shkollës së arsimit bazë e kanë plotësuar normën e tyre mësimore javore vetëm me orë të profilit të diplomës që zotërojnë. Nëndrejtori i shkollës së arsimit bazë, kur shkolla nuk ka sekretar, është ngarkuar për amzën dhe inventarin e shkollës.		
Kreu II, Gërma E, Pika 1	Drejtori i shkollës së arsimit bazë, me 81-900 nxënës, ka realizuar normën e vlerësimit të arritjeve me 4 orë në javë (3 orë për vlerësimin e cilësisë së procesit mësimor dhe 1 orë për dokumentacionin shkollor).		
Kreu II, Gërma E, Pika 2	Drejtori i shkollës së arsimit bazë, me mbi 900 nxënës, ka realizuar normën e vlerësimit të arritjeve me 3 orë në javë (2 orë për vlerësimin e cilësisë së procesit mësimor dhe 1 orë për dokumentacionin shkollor).		
Kreu II, Gërma E, Pika 3	Nëndrejtori i shkollës së arsimit bazë, ka realizuar normën e vlerësimit të arritjeve me 4 orë në javë (3 orë për vlerësimin e cilësisë së procesit mësimor dhe 1 orë për dokumentacionin shkollor).		
Kreu II, Gërma E, Pika 4	Nëndrejtori i shkollës së arsimit bazë, me mbi 900 nxënës, ka realizuar normën e vlerësimit të arritjeve me 3 orë në javë (2 orë për vlerësimin e cilësisë së procesit mësimor dhe 1 orë për dokumentacionin shkollor).		
Kreu III, Gërma A, Pika 1	Në arsimin e mesëm të lartë (AML) janë formuar klasat me jo më pak së 25 nxënës në zonat urbane dhe me jo më pak së 15 nxënës në zonat rurale.		
Kreu III, Gërma A, Pika 2, Gërma a	Në AML janë formuar dy klasa paralele, kur numri i nxënësve është 36-70.		
Kreu III, Gërma A,	Në AML janë formuar tri klasa paralele, kur numri i nxënësve		

Pika 2, Gërma b	është 71-105.		
Kreu III, Gërma A, Pika 2, Gërma c	Në AML janë formuar katër klasa paralele, kur numri i nxënësve është 106-140.		
Kreu III, Gërma A, Pika 2, Gërma d	Në AML janë formuar pesë klasa paralele, kur numri i nxënësve është 141-175.		
Kreu III, Gërma A, Pika 2, Gërma e	Ndarja e klasave në AML, në më shumë se pesë klasa paralele, ka vazhduar sipas rregullit në këtë pikë (2).		
Kreu III, Gërma B, Pika 1	Në AML, kur numri i nxënësve është 251-500, është emëruar një nëndrejtor shkolle.		
Kreu III, Gërma B, Pika 2	Në AML, kur numri i nxënësve është 501-900, janë emëruar dy nëndrejtorë shkolle.		
Kreu III, Gërma B, Pika 3	Në AML, kur numri i nxënësve është mbi 900 nxënës, janë emëruar tre nëndrejtorë shkolle.		
Kreu III, Gërma C, Pika 1	Mësuesi i gjuhës shqipe dhe i letërsisë në AML e ka normën mësimore 18 orë në javë.		
Kreu III, Gërma C, Pika 2	Në AML, mësuesit e gjuhës së huaj, matematikës, fizikës, biologjisë, kimisë, informatikës, historisë, gjeografisë, teknologjisë, shkencave shoqërore (filozofi, psikologji, qytetari, sociologji) dhe ekonomisë e kanë normën mësimore 20 orë në javë.		
Kreu III, Gërma C, Pika 3	Mësuesit e lëndëve të tjera në AML e kanë normën mësimore 22 orë në javë.		
Kreu III, Gërma C, Pika 4	Drejtori i shkollës në AML, me 81-300 nxënës, e ka normën mësimore 8 orë në javë, sipas profilit të diplomës që zotëron.		
Kreu III, Gërma C, Pika 5	Drejtori i shkollës në AML, me 301-600 nxënës, e ka normën mësimore 6 orë në javë, sipas profilit të diplomës që zotëron.		
Kreu III, Gërma C, Pika 6	Drejtori i shkollës në AML, me 601-900 nxënës, e ka normën mësimore 4 orë në javë, sipas profilit të diplomës që zotëron.		
Kreu III, Gërma C, Pika 7	Drejtori i shkollës në AML me mbi 900 nxënës nuk jep mësim.		
Kreu III, Gërma C, Pika 8	Nëndrejtori i shkollës në AML e ka normën mësimore 8 orë në javë, sipas profilit të diplomës që zotëron dhe, kur shkolla nuk ka sekretar, është ngarkuar për amzën dhe inventarin e shkollës.		
Kreu III, Gërma C	Drejtori dhe nëndrejtorët e shkollës së arsimit të mesëm të lartë e kanë plotësuar normën e tyre mësimore javore vetëm me orë të profilit të diplomës që zotërojnë. Nëndrejtori i shkollës së arsimit të mesëm të lartë, kur shkolla nuk ka sekretar, është ngarkuar për amzën dhe inventarin e shkollës.		
Kreu III, Gërma D, Pika 1	Drejtori i shkollës në AML, me 81-900 nxënës, e ka normën e vlerësimit të arritjeve 4 orë në javë (3 orë për vlerësimin e cilësisë së procesit mësimor dhe 1 orë për dokumentacionin shkolle).		
Kreu III, Gërma D, Pika 2	Drejtori i shkollës në AML, me mbi 900 nxënës, e ka normën e vlerësimit të arritjeve 3 orë në javë (2 orë për vlerësimin e cilësisë së procesit mësimor dhe 1 orë për dokumentacionin		

	shkollor).		
Kreu III, Gërma D, Pika 3	Nëndrejtori i shkollës në AML e ka normën e vlerësimit të arritjeve 4 orë në javë (3 orë për vlerësimin e cilësisë së procesit mësimor dhe 1 orë për dokumentacionin shkollor).		
Kreu III, Gërma D, Pika 4	Nëndrejtori i shkollës në AML, me mbi 900 nxënës, e ka normën e vlerësimit të arritjeve 3 orë në javë (2 orë për vlerësimin e cilësisë së procesit mësimor dhe 1 orë për dokumentacionin shkollor).		
Kreu IV, Gërma A, Pika 1	Në shkollat e arsimit të orientuar klasat e veçanta janë formuar me jo më pak së 15 nxënës.		
Kreu IV, Gërma A, Pika 2, Gërma a	Shkolla e arsimit të orientuar ka formuar dy klasa paralele, kur numri i nxënësve është 36-70.		
Kreu IV, Gërma A, Pika 2, Gërma b	Shkolla e arsimit të orientuar ka formuar tri klasa paralele, kur numri i nxënësve është 71-105		
Kreu IV, Gërma A, Pika 2, Gërma c	Shkolla e arsimit të orientuar ka formuar katër klasa paralele, kur numri i nxënësve është 106-140		
Kreu IV, Gërma A, Pika 2, Gërma d	Shkolla e arsimit të orientuar ka formuar pesë klasa paralele, kur numri i nxënësve është 141-175		
Kreu IV, Gërma A, Pika 2, Gërma e	Në shkollën e arsimit të orientuar, ndarja e klasave në më shumë se pesë klasa paralele, ka vazhduar sipas rregullit të kësaj pike.		
Kreu IV, Gërma B, Pika 1	Në shkollën e arsimit të orientuar, kur numri i nxënësve është 201-400, është emëruar një nëndrejtor shkolle.		
Kreu IV, Gërma B, Pika 2	Në shkollën e arsimit të orientuar, kur numri i nxënësve është 401-600, janë emëruar dy nëndrejtorë shkolle.		
Kreu IV, Gërma B, Pika 3	Në shkollën e arsimit të orientuar, me mbi 600 nxënës, janë emëruar tre nëndrejtorë shkolle.		
Kreu IV, Gërma C, Pika 1	Në shkollën e arsimit të orientuar, mësuesi i gjuhës shqipe dhe i letërsisë e ka normën mësimore 18 orë në javë.		
Kreu IV, Gërma C, Pika 2	Në shkollën e arsimit të orientuar, mësuesi i gjuhës së huaj, i matematikës, i fizikës, i biologjisë, i kimisë, i informatikës, i historisë, i gjeografisë, i teknologjisë, i shkencave shoqërore (filozofi, psikologji, qytetari, sociologji) dhe i ekonomisë e ka normën mësimore 20 orë në javë.		
Kreu IV, Gërma C, Pika 3	Mësuesit e lëndëve të tjera në shkollën e arsimit të orientuar e kanë normën mësimore 24 orë në javë.		
Kreu IV, Gërma C, Pika 4	Në shkollën e arsimit të orientuar, mësuesi shoqëruar në piano e ka normën mësimore 30 orë në javë.		
Kreu IV, Gërma C, Pika 5	Drejtori i shkollës së arsimit të orientuar, me 81-200 nxënës, e ka normën mësimore 8 orë në javë.		
Kreu IV, Gërma C, Pika 6	Drejtori i shkollës së arsimit të orientuar, me 201-600 nxënës, e ka normën mësimore 6 orë në javë.		
Kreu IV, Gërma C, Pika 7	Drejtori i shkollës së arsimit të orientuar me mbi 600 nxënës nuk jep mësim.		
Kreu IV, Gërma C,	Nëndrejtori i shkollës së arsimit të orientuar, me 201-400		

Pika 8	nxënës, e ka normën mësimore 8 orë në javë, sipas profilit të diplomës që zotëron.		
Kreu IV, Gërma C, Pika 9	Nëndrejtori i shkollës së arsimit të orientuar, me mbi 400 nxënës, e ka normën mësimore 6 orë në javë.		
Kreu IV, Gërma C	Drejtori dhe nëndrejtorët e shkollës së arsimit të orientuar e kanë plotësuar normën e tyre mësimore javore vetëm me orë të profilit të diplomës që zotërojnë. Nëndrejtori i shkollës së arsimit të orientuar, kur shkolla nuk ka sekretar, është ngarkuar për amzën dhe inventarin e shkollës.		
Kreu IV, Gërma D, Pika 1	Drejtori i shkollës së arsimit të orientuar, me 81-600 nxënës, e ka normën e vlerësimit të arritjeve 4 orë në javë (3 orë për vlerësimin e cilësisë së procesit mësimor dhe 1 orë për dokumentacionin shkollor).		
Kreu IV, Gërma D, Pika 2	Drejtori i shkollës së arsimit të orientuar me mbi 600 nxënës e ka normën e vlerësimit të arritjeve 3 orë në javë (2 orë për vlerësimin e cilësisë së procesit mësimor dhe 1 orë për dokumentacionin shkollor).		
Kreu IV, Gërma D, Pika 3	Nëndrejtori i shkollës së arsimit të orientuar e ka normën e vlerësimit të arritjeve 4 orë në javë (3 orë për vlerësimin e cilësisë së procesit mësimor dhe 1 orë për dokumentacionin shkollor).		
Kreu IV, Gërma E, Pika 1	Shkolla artistike zhvillon orët teorike me të gjithë klasën në lëndët: harmoni, analizë e veprave muzikore, histori e muzikës shqiptare dhe botërore, folklor muzikor, literaturë muzikore, orkestracion, deshifrazh, histori arti, perspektivë, anatomi dhe estetikë.		
Kreu IV, Gërma E, Pika 2	Shkolla artistike zhvillon orët praktike në grupe me 4-5 nxënës në lëndët: harmoni, analizë e veprave muzikore dhe orkestracion.		
Kreu IV, Gërma E, Pika 3	Shkolla artistike zhvillon mësim individual me 1 nxënës në lëndët: instrumentist, mjeshtëri e të kënduarit dhe piano sekondare.		
Kreu IV, Gërma E, Pika 4	Shkolla artistike në lëndën muzikë dhome zhvillon mësimin në grupe me 2-5 nxënës, si dhe në varësi të formacionit dhe programit mësimor krijohen edhe duete.		
Kreu IV, Gërma E, Pika 5	Shkolla artistike zhvillon shoqërimin e instrumentistëve në saxhio: harqet 8 orë mësimi në vit për nxënës, instrumentet e frymës 6 orë mësimi në vit për nxënës.		
Kreu IV, Gërma E, Pika 6	Shkolla artistike në degën e artit figurativ, e zhvillon mësimin në grupe me jo më pak se 8 nxënës në lëndët: vizatim, pikturë, plastikë.		
Kreu IV, Gërma E, Pika 7	Shkolla artistike në lëndët e specialiteteve të artit figurativ e zhvillon mësimin në grupe me jo më pak se 4 nxënës.		
Kreu IV, Gërma E, Pika 8	Shkolla koreografike e zhvillon lëndën piano sekondare në grupe me nga 4 nxënës.		
Kreu V, Pika 1	Mësuesi i arsimit parauniversitar e plotëson normën mësimore javore me lëndë të profilit të tij. Kur nuk ka orë të mjaftueshme në profilin e tij, ai është ngarkuar me orë mësimore të profileve të përafërta, sipas		

	shtojcës bashkëlidhur këtij udhëzimi.		
Kreu V, Pika 2	Të gjitha normat e veçanta, të përcaktuara në kreun V të këtij udhëzimi, për efekte financiare, janë llogaritur me vlerën e orës mësimore.		
Kreu V, Pika 3	Masa e pagesës për orën suplementare është bërë sipas tarifës së orës mësimore suplementare, e miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave.		
Kreu V, Pika 4	Si orë suplementare janë llogaritur orët mësimore, të cilat janë realizuar nga mësuesi mbi normën javore të tij.		
Kreu V, Pika 5	Si normë javore është llogaritur norma mësimore që i është ngarkuar mësuesit/drejtuesit për çdo javë të vitit mësimor. Në normën javore të mësuesit janë përfshirë orët e mësimimit të çdo lënde që përmban plani mësimor dhe çdo orë e përcaktuar në kreun V, të këtij udhëzimi.		
Kreu V, Pika 6	Pagesa e orëve suplementare është kryer në fund të çdo muaji. Drejtoria e shkollës la llogaritur periodikisht pagesat e orëve suplementare, me qëllim që në fund të muajit pagesa e orëve suplementare të përfituara nga mësuesit gjatë muajit përkatës, të jetë në përputhje me orë faktike të realizuara nga mësuesi.		
Kreu V, Pika 7	Në arsimin fillor, orët suplementare për efekt pagese, për mësuesin/kryemësuesin, janë llogaritur mbi normën javore, kur klasa kolektive ka mbi 10 nxënës.		
Kreu V, Pika 8	Në AMU dhe në AML mësuesit nuk kanë orë suplementare më shumë se 30% të normës mësimore.		
Kreu V, Pika 9	Puna e mësuesit kujdestar në shkollat e arsimit parauniversitar, është barazvlerësuar me 2 orë mësimore në javë.		
Kreu V, Pika 10, Gërma a	Mësuesit që drejton bibliotekën e shkollës dhe punon me librin, i janë llogaritur si ngarkesë mësimore 3 orë në javë, kur shkolla ka bibliotekë dhe ka 201-600 nxënës.		
Kreu V, Pika 10, Gërma b	Mësuesit që drejton bibliotekën e shkollës dhe punon me librin, i janë llogaritur si ngarkesë mësimore 4 orë në javë, kur shkolla ka bibliotekë dhe ka mbi 600 nxënës.		
Kreu V, Pika 11	Zhvillimi i veprimtarive konkrete, në kuadër të shkollës si qendër komunitare, është llogaritur 10 orë në javë.		
Kreu V, Pika 12	Mësuesit, që është drejtues i një rrjeti profesional, i janë llogaritur 2 orë mësimore në javë.		
Kreu V, Pika 13	Për zhvillimin e veprimtarive të miratuara në kuadër të nismës “Bëjmë detyrat e shtëpisë”, ora e studimit është llogaritur e barasvlershme me orën mësimore. Institucioni arsimor i përfshirë në këtë nismë ka realizuar jo më shumë se 3 orë studimi në ditë për çdo klasë të formuar.		
Kreu V, Pika 14	Mësuesit që merret me veprimtaritë artistike dhe mësuesit që kryen detyrën e koordinatorit të qeverisë së nxënësve për shkollat nën 700 nxënës, i është llogaritur 2 orë në javë dhe për shkollat me mbi 700 nxënës, 4 orë në javë.		
Kreu V, Pika 15	Mësuesit, në shkollat me më shumë se 700 nxënës që kanë palestër, kur krijojnë dhe stërvitin ekipe sportive, jo më shumë se dy lloje sporti për femra dhe meshkuj, i është ulur norma		

	mësimore me 3 orë në javë.		
Kreu V, Pika 16	Mësimi i lëndës së edukimit fizik zhvillohet i ndarë sipas gjinisë dhe, kur ka qenë e mundur, mësuesi është caktuar i së njëjtës gjini me nxënësit.		
Kreu V, Pika 16, Gërma a	Në AMU dhe AML, kur numri i nxënësve për çdo gjini është jo më pak se 10 nxënës, mësimi i edukimit fizik bëhet i ndarë në gjini.		
Kreu V, Pika 16, Gërma b	Në AMU dhe AML që kanë klasa paralele, kur numri i nxënësve për çdo gjini në të paktën një paralel, është më i vogël se 10 nxënës, mësimi i edukimit fizik është bërë i ndarë në gjini, por duke bashkuar dy paralele.		
Kreu V, Pika 16, Gërma c	Në AMU dhe AML, që nuk kanë klasa paralele, kur numri i nxënësve për çdo gjini është më i vogël se 10, mësimi i edukimit fizik bëhet pa u ndarë në gjini.		
Kreu V, Pika 17	Për zhvillimin e praktikës në shkollat e mesme të gjuhëve të huaja, të lëndëve të specialitetit në shkollat koreografike dhe teori solfezhi në shkollat e muzikës, kur klasa ka mbi 20 nxënës është ndarë në dy grupe.		
Kreu V, Pika 18	Orët për shoqërimin dhe drejtimin e nxënësve (klasës) në praktikat profesionale mësimore janë llogaritur 1.5 orë praktikë = 1 orë mësimore.		
Kreu V, Pika 19	Mësuesit, që kanë vlerësuar testimet e provimeve kombëtare të arsimit bazë, i është llogaritur për efekt pagese 1 orë mësimore për 3 teste të vlerësuara.		
Kreu V, Pika 20	Mësuesit, që kanë vlerësuar fazën II të olimpiadave kombëtare të organizuara nga ministria përgjegjëse për arsimin, i është llogaritur për efekt pagese 1 orë mësimore për 3 teste të vlerësuara.		
Kreu V, Pika 21	Mësuesit të ngarkuar për plotësimin e amzës së shkollës, kur shkolla nuk ka as nëndrejtor dhe as sekretar, i është ulur norma mësimore me 2 orë në javë.		
Kreu V, Pika 22	Mësuesve mentorë, për mentorimin e një praktikanti, u është ulur 1/4 e normës javore. Një mësues mentoron 1-4 praktikantë. Kur mësuesi mentoron më pak se 4 praktikantë e plotëson normën javore si mësues.		
Kreu V, Pika 23	Në klasën e dymbëdhjetë të gjimnazit, lëndët me zgjedhje janë zhvilluar në bazë të kërkesave të nxënësve.		
Kreu V, Pika 24	Specialistët që zhvillojnë orë të veçanta në institucionet e arsimit parauniversitar (shkolla), janë paguar vetëm për orët e mësimit që kanë zhvilluar.		